



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 276/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për shkak të materialit zgjedhor afër qendrës së votimit në komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 276/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA

### A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA në të cilën thekson se në afërsi të shkollës së mesme ekonomike "ISA Boletini" në qytetin e Podujevës, në afërsi prej 30 metrave është vërejtur materiali promovues-posteri i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar:**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla mesme ekonomike "Isa Boletini" në qytetin e Podujevës dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për te votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 276/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*